



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke



ZL.Anr.395/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Adnan Konushevci dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Fitore Isufi, duke vendosur përkitazi me ankesën e kandidatës për anëtare të Kuvendit Komunal në Obiliq, Shkurte Raçi nga radhët e subjektit politik LVV, me seli në Prishtinë, dega në Obiliq, për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 26.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET si e parregullt ankesa ZL.A.nr.395/2017, e kandidatës për anëtare të Kuvendit Komunal të Obiliqit, Shkurte Raçi nga radhët e subjektit politik LVV, me seli në Prishtinë, dega në Obiliq, e paraqitur me datën 23.10.2017, për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017

A r s y e t i m

Me datën 23.10.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Shkurte Raçi, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal të Obiliqit, nga radhët e subjektit politik LVV, me të cilat pretendon se i janë keqpërdorur votat, në Qendrën e Votimit të Komunës së Obiliqit, si në: Vendvotim nr.1501e/05/R, në shkollën fillore “Ibrahim Rugova” në Obiliq.

Paneli, pasi që shqyrtoj paraprakisht rregullsinë e ankesës, gjeti se:

Ankesa është e pa rregullt

PZAP-i, nga shkresat e lëndës vlerësoj se ankesa e parashtruar nga ana e kandidatës për anëtare të Kuvendit Komunal të Obiliqit, Shkurte Raçi nga radhët e subjektit politik LVV, me seli në Prishtinë, dega në Obiliq është e parregullt, sepse nuk është nënshkruar nga parashtruesja e ankesës dhe si e tillë ankesa nuk i plotëson kërkesat e Rregullës Nr.02/2015 të nenit 5.6 ku përcaktohet se: *“Ankesat duhet të dorëzohen me shkrim dhe duhet të jenë të nënshkruara nga ankuesi apo në emër të tij nga i autorizuari”*.

Prandaj, PZAP-i nuk u lëshua fare në meritat e ankesës, ngase nuk janë plotësuar kushtet e kërkuara nga dispozita e lartëtheksuara.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

ZL. Anr.395/2017 më datën 26.10.2017.



**Kryesuesi i Panelit
Fejzullah Rexhepi**

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.*